



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 1
Prishtinë, më 12 tetor 2017, në orën 10:00,
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Verica Çaraniq, Shqipe Pantina, Avdullah Hoti, Andin Hoti, Blerim Kuqi dhe Albert Kinolli.

Munguan: Faton Topalli dhe Zafir Berisha.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj dhe Mehmet Simnica.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Mentor Hyseni- GIZ, Shkëlqim Xhema- ZKA, dhe Rrezarta Zekaj- RTK Radio.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

1. Konstituimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Kryetari pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

Driton Selmanaj, kryetar: Fillimisht ju dëshiroj të gjithë deputetëve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, punë të mbarë dhe meqenëse është takim konstituiv dhe shumica nga ne janë deputet për herë të parë, do të ishte mirë të prezantohemi secili veç e veç..

Pas prezantimit të anëtarëve të komisionit, kryetari i njoftoi anëtarët e komisionit që ky komision ka edhe stafin mbështetës me një koordinatorë dhe një zyrtar të fushës, si dhe një staf mbështetës nga GIZ-i.

Stafi më ka njoftuar me çështjet të cilat na presin për t'i shqyrtuar. Pikat kryesore i keni para vetes, por ndër to, do të doja ti theksoja dy: Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2016, të cilin do të duhej që Kuvendi ta shqyrtojë deri më 31 tetor, ndërsa çështja tjetër ka të bëjë me Auditimin e subjekteve politike. Kuvendi i Kosovës, përmes procedurave të prokurimit ka arritur të zgjedhë një kompani që do të bëjë auditimin e subjekteve politike për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, por që me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike kërkohet që ky komision të zhvillojë procesin e caktimit të auditorëve me short se cili auditorë, cilin subjekt politik do ta auditojë. Kontrata e Kuvendit me operatorin ekonomik është nënshkruar në qershor të këtij viti, prandaj edhe koha për përfundimin e këtij procesi brenda këtij viti është e shkurt, dhe ne do të duhej ta zhvillojmë këtë proces javën e ardhshme. Kërkoj komentet e juaja sidomos për çështjen e dytë, prandaj e hapi diskutimin.

Shqipe Pantina- Sa e kuptova unë auditorët kanë 45 ditë kohë për të audituar subjektet politike për katër vite. Unë nuk jam auditore por mua s'ingjerisht po më duket si jo e drejt prej atyre auditorëve sepse është periudhë shumë e shkurt. Po ashtu, është kohë shumë e papërshtatshme për të gjitha subjektet politike sepse jemi në mes të fushatës, mirëpo, meqenëse është kërkesë ligjore atëherë neve na duhet ta zbatojmë, megjithëkëtë pasi janë në dispozicion vetëm 45 ditë, nuk e di sa do të jetë cilësia e këtij auditimi.

Kryetari- Ata besoj e kanë vlerësuar kohën, duke pas parasysh që e kanë nënshkruar kontratën me këto kushte me Kuvendin.

Avdullah Hoti- Unë i pash çështjet që i kemi në pritje dhe me ndihmën edhe stafit do të duhej ta shikojmë bazën ligjore për secilën çështje. Ajo që unë propozoj është që ne të merremi vesh për caktimin e dy- tri mbledhjeve të radhës dhe ti kemi në rendin e ditës këto pika me radhë, në mënyrë që të njihemi në detaje për secilën çështje.

Kryetari- Stafi me ka njoftuar që ne, me mbështetjen e stafit, do të duhej ta përgatisim një plan të punës, por duke pasur parasysh që për këtë vit është një periudhë e shkurt, do ta diskutojmë bashkërisht nëse do ta kemi një plan pune për këta dy muaj apo jo.

Mërgim Lushtaku- Unë e vlerësoj që nuk është e nevojshme ta kemi një plan pune për dy muaj, por ta kemi një njoftim më të detajuar për pikat që i kemi të listuara këtu sot, dhe pastaj planin e punës ta përgatisim për vitin tjetër.

Blerim Kuqi- Mua më vjen mirë që ne sot e kemi një listim të pikave sipas prioritetit kohor që na pret, të cilat janë shumë më me rendësi se sa plani i veprimit. Ne planin e veprimit do ta bëjmë për vitin e ardhshëm por e vlerësoj që ne duhet të punojmë sipas prioritetëve që i kemi me kohë. Ndërsa e dyta që nuk po e kuptoj është që pse do të duhej të bëhet tërheqja e shortit për auditimin e subjekteve nga ana e komisionit pasi që është kontraktua një kompani, sepse kompania i ka rregullat e veta të punës. A ka rregull që na obligon neve që ta bëjmë këtë punë a si është e rregulluar.

Kryetari- Për caktimin e shortit na obligon, Ligji për Financimin e Partive Politike. Ky proces është për herë të parë, prandaj mendoj që na duhet të konsultohemi më në detaje,

prandaj propozoj që ta mbajmë një takim të mërkurën dhe ti diskutojmë në detaje këto çështje.

Shqipe Pantina- Disa nga ne jemi në dy komisione, andaj kisha kërkuar nga ju, që në takimin e kryetarëve të komisioneve me Kryetarin e Kuvendit, ta diskutoni edhe këtë çështje, në mënyrë që të bëjmë koordinimin që komisionet mos të kenë takime në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën. Shpresoj që ta keni këtë çështje parasysh.

Albert Kinolli- Me gjithë respektin për kolegët, po të gjithë kemi angazhime por nëse shikojmë t'ju përshtatemi të gjithëve e kemi të pamundur pastaj të mbajmë takime. E rëndësishme është me pas kuorum. Por besoj që me kohë do ti tejkalojmë këto probleme teknike dhe e rëndësishme është që ne të vazhdojmë me punë.

Kryetari- Atëherë sipas diskutimeve po e vlerësoj që mbledhjen e radhës ta kemi të martën në orën 10:00, ndërsa në orën 11:00, do të shkojmë në vizitë në Zyrën Kombëtare të Auditimit, ku do të njoftohemi në detaje me punën e tyre.

Me kaq e konsideroj këtë takim të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45

Kryetari i Komisionit

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Driton Selmanaj